



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 811/9 Prot

Tiranë, më 28.12.2020

**V E N D I M**

Nr.216, datë 28.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së mosveprimit të njësisë përgjegjëse, për pajisjen e nëpunës \*\*\*\*\* me vlerësimin e rezultateve për vitin e fundit të punës.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësja \*\*\*\*\*, për mospajisjen e saj me vlerësimin e rezultateve në punë, nga ana e eprorit direkt, për vitin e fundit të punës,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\* , protokolluar me nr.811/1 prot, datë 09.11.2020 është ngritur pretendimi se pa të drejtë, nuk është pajisur me vlerësimin e vitit të fundit të punës, nga ana e eprorit direkt dhe njësisë përgjegjëse, gjë e cila është bërë pengesë për pjesëmarrjen e saj në një konkurrim për të cilin ajo ka shfaqur interes.

Nga përmbajtja e kërkesës së mësipërme rezulton se \*\*\*\*\* , nëpunëse civile e nivelit të mesëm drejtues, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, në Bashkinë Durrës, nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 811 prot, datë 02.11.2020, parashtron se pas dhënies së dorëheqjes prej pozicionit të punës “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, dhe ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil për këtë shkak në Dhjetor 2019, nuk është pajisur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin e fundit të punës, gjë e cila është bërë

pengesë për të marrë pjesë në konkurrim, sipas mundësisë që jep pika 4, e nenit 64, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së mosveprimit të kryer nga institucioni në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimin mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III “Proçedura paraprake”, të Rregullores “Mbi proçedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u krye verifikimi i çështjes prej nga rezultoi e vërtetuar se, \*\*\*\*\* ka qenë nëpunëse civile e konfirmuar, në administratën e Bashkisë Durrës, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, që prej datës 01.02.2018.

Në datën 16.12.2019, për arsye personale, ajo ka paraqitur dorëheqjen nga detyra, e cila është miratuar nga njësia përgjegjëse, duke shënuar në këtë mënyrë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Nga ana e saj ngrihet pretendimi se në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, pa ndonjë shkak të ligjshëm, nuk është pajisur me vlerësimin e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2019, gjë e cila ka sjellë si pasojë mos kualifikimin e saj për pjesëmarrje në konkurrimin e shpallur nga Departamenti i Administratës Publike, me kod #3270, nëpërmjet lëvizjes paralele, në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Statistikës” në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Moskualifikimi i kërkueses \*\*\*\*\* nga ana e njësisë përgjegjëse, në kushtet e mësipërme, është një veprim i bazuar në legjislacionin e shërbimit civil, pasi sipas pikës 10, të vendimit nr.242 dt. 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” në dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, përfshihen edhe dy vlerësimet e vitit të fundit të punës, me rezultat pozitiv.

Konkurrentja, këto vlerësime nuk i ka patur në dispozicion, pasi njësia përgjegjëse e Bashkisë Durrës dhe eprori i saj direkt, nuk e kishin përmbushur këtë detyrim, që parashikohet në pikën 1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë kryerjes së procesit të hetimit administrativ të këtij rasti, ankuesja njofton se pas ndërhyrjes së Komisionerit për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të njësisë përgjegjëse të bashkisë dhe eprorit direkt të kërkueses, këta të fundit kanë reaguuar pozitivisht, duke plotësuar dokumentacionin e munguar të kërkueses dhe pas kësaj, Departamenti i Administratës Publike e ka kualifikuar atë për të marrë pjesë në konkurrim, duke i dhënë fund në këtë mënyrë, mosmarrëveshjes së lindur.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses \*\*\*\*\* për shkelje të kryera lidhur me mospajisjen me vlerësimin e rezultateve të vitit të fundit të punës, në

Bashkinë Durrës, është marrë parasysh nga kjo e fundit, duke e plotësuar detyrimin ligjor, prandaj çmohet se nuk është e nevojshme të vijojë hetimi administrativ dhe çështja duhet të arkivohet.

Megjithatë, i tërhiqet vëmendja Njesisë Përgjegjëse të Bashkisë Durrës, që në çdo rast duhet të plotësohen detyrimet ligjore, në mënyrë që nëpunësit civilë të mund të realizojnë kërkesat e tyre të ligjshme.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

- 1- Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 811/1 prot., datë 09.11.2020, të paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, për mospajisjen e saj me vlerësimin e rezultateve për vitin e fundit të punës, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, në Bashkinë Durrës, dhe arkivimin e çështjes.
- 2- Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Durrës dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**